



FORUM FOR
REASONABLE POLICIES

Форум за разумни политики



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

UDHËZUES PËR POLITIKANË TË VIRTUTSHËM 2.0

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE DHE
PARLAMENTARE 2024: RAPORT PËR
ETIKËN E ZGJEDHJEVE



SHKUP, MAJ 2024

PËRMBAJTJA

HYRJE

Kontekstualizimi
Imperativi i etikës zgjedhore
Mënyra e vlerësimit të sjelljes së partive dhe aktorëve politikë

1 METODOLOGJIA

Perspektiva qytetare
Të dhënat kërkimore dhe burimet
Parametrat për analizë
Korniza teorike dhe analiza komparative

2 KONTEKSTI POLITIK I ZGJEDHJEVE NË VITIN 2024 DHE MODELET E SJELLJES SË QYTETARËVE NË ZGJEDHJE

Konteksti global dhe ndikimet në sjelljen e partive dhe kandidatëve për president
Konteksti rajonal dhe ndikimet mbi sjelljen e partive dhe kandidatëve për president
Konteksti i brendshëm shtetëror dhe ndikimet mbi sjelljen e qytetarëve dhe partive dhe kandidatëve për president

3 ANALIZA E SJELLJES SË KANDIDATËVE PËR PRESIDENT

Profili ideologjiko-programor i kandidatëve për president
Përkushtimi në ofertën ose sulmi ndaj kundërshtarëve
Fokusimi në mesazhe politike apo programore
Kultura e kompromisit
Ndryshimi i qëndrimeve politike gjatë fushatës
Dezinformatat dhe fushata e zezë

4 ANALIZA E SJELLJES SË PARTIVE PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Profili ideologjiko-programor i partive politike
Përkushtimi në ofertën ose sulmi ndaj kundërshtarëve
Fokus në mesazhe politike apo programore
Kultura e kompromisit
Ndryshimi i qëndrimeve politike gjatë fushatës
Dezinformatat dhe fushata e zezë

PERCEPTIMET PËRFUNDIMTARE

REKOMANDIME Për Avancimin E Proceseve Zgjedhore Dhe Demokratike



HYRJE

Vendimi i qytetarëve në ditën e zgjedhjeve ka pasoja të mëdha në dinamikën e brendshme të shoqërisë dhe mund të sinjalizojë ndryshime në disponimin e publikut për prioritetet politike, mënyrën e qeverisjes demokratike, formësimin e perceptimeve për stabilitetin rajonal dhe perspektivat e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Vetë akti i votimit të qytetarit, edhe pse minor në dukje si veprimtari politike individuale, mund të ndikojë në mënyrë dramatike në peizazhin e ardhshëm politik të një vendi, kurse implikimet e një votës së tillë, prekin edhe aspektet rajonale dhe ndërkombëtare në udhëheqjen e vendit.

Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në Maqedoninë e Veriut, të mbajtura më 24 prill dhe 8 maj 2024, paraqesin një moment të rëndësishëm, ndërsa në disa aspekte edhe një moment kritik në të cilin qytetarët kanë rol kyç në raport me trajektoren nëpër të cilën do të lëvizë shteti. Ato mbahen në një atmosferë të prishur besimi të qytetarëve ndaj elitave politike dhe institucioneve demokratike në përgjithësi, dhe ndaj prioriteteve të politikës së jashtme të shtetit në veçanti. Perepcioni për një aparat shtetëror joefikas që nuk ballafaqohet me korrupsionin dhe nuk vendos shtetin e së drejtës, është bërë një diskurs përgjithësisht i pranuar që i përgjigjet vetëm qeverisë aktuale, duke u përhapur edhe në nivelin ndëretnik. Nga ana tjetër, dera gjysmë e hapur për fillimin e negociatave me Bashkimin Evropian dhe përfshirja e kushtëzuar e pakicës etnike bullgare në kushtetutë, krijon një hendek serioz në shoqëri, sidomos midis maqedonasve etnikë, me implikime po aq të qarta për marrëdhëniet ndëretnike. Në sfondin e këtyre ngjarjeve dhe dinamikave komplekse shoqërore, qytetarët e dhanë votën e tyre.

Zgjedhjet janë një lakmus test për integritetin e institucioneve demokratike dhe standardin etik të aktorëve politikë. Shumica e matjeve dhe raporteve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që punojnë për përmirësimin e procesit zgjedhor, fokusohen në analizën e aspektit formal të zgjedhjeve dhe në vetë ditën e zgjedhjeve. Gjithashtu, vlerësimet në raportet e OSBE/ODIHR tregojnë kryesisht matjen dhe analizën e cilësisë së organizimit të zgjedhjeve dhe respektimin e dispozitave ligjore.

Ky Raport mbi etikën zgjedhore ka një ambicie modeste por të qartë për të përfaqësuar një lloj udhëzuesi për sjelljen e një politikani/eje të virtytshëm/me. I njëjti depërton thellë në veprimet e partive politike dhe kandidatëve presidencialë, duke i analizuar ato përmes thjerrëzës së etikës zgjedhore dhe perceptimit që ata krijojnë përmes mediave në diskursin publik. Qëllimi i tij është të shërbejë si udhërrëfyes për sjelljen e ardhshme të virtytshme politike zgjedhore, por edhe përkujtues për institucionet kompetente që të merren më seriozisht me aspektet e vështira për t'u matur, por megjithatë aspekte kyçe të etikës në procesin zgjedhor.

Raporti nuk pretendon të jetë gjithëpërfshirës, por ofron një perspektivë unike sepse qytetari sheh dhe dëgjon gjatë fushatës zgjedhore, i detekton dobësitë e procesit zgjedhor, hendekun vlerësor midis dy cikleve zgjedhore, aspekte që nuk janë sistemore apo institucionale. por të rrënjosur thellë në shoqëri dhe kulturën tonë politike.

"Variablat e vështira" të cilat i mbulon raporti, në fakt shpesh janë "të vështira" për t'u matur dhe të margjinalizuara apo të analizuar periferikisht duke hequr aktorët e përfshirë në procesin zgjedhor. Megjithatë, në Forumin për Politika të Arsyeshme, jemi të bindur dhe insistojmë me këmbëngulje se dimensionin etik të politikës dhe veçanërisht i procesit zgjedhor ndjeshëm, e në disa vende në mënyrë kritike, ndikon në zgjedhjen e qytetarëve dhe doemos të ngrihet në nivelin dhe standardin që qytetarët e meritojnë në një sistem demokratik.

Imperativi i etikës zgjedhore

Në zemër të demokracisë funksionale qëndron parimi i etikës zgjedhore, respektivisht zgjedhje të cilat janë të lira, të drejta, transparente, pa manipulime, që ngjallin besim te qytetarët për vlerat e tyre dhe pritshmëritë e tyre për udhëheqjen e ardhshme të shtetit.

Mosrespektimi dhe mosnjohja e rezultateve zgjedhore ndikon në besimin e qytetarëve në institucionet, e rrjedhimisht edhe në vetë demokracinë si sistem. Në proporcion të drejtë, përgjegjësia e institucioneve dhe partive për garantimin e integritetit të procesit zgjedhor dhe gjurmimi i institucioneve legjitime që rrjedhin prej tij, krijon nevojën për vendosjen e standardeve etike në atmosferën zgjedhore që do të nxisin pjesëmarrje dhe besim të lartë tek qytetarët.

Mënyra e vlerësimit të sjelljes së partive dhe aktorëve politikë: Sjellja e partive politike dhe e kandidatëve presidencialë, është subjekt i monitorimit në dimensioneve të ndryshme të etikës zgjedhore. Në këtë kontekst, karakteri i këtij vlerësimi, ndër të tjera, varet nga pesë aspektet e mëposhtme:

Transparenca e financimit të fushatave: Zbardhja transparente e financimit të fushatës, është thelbësore për të parandaluar ndikimin jo adekuat të interesave të partikuluara dhe për të siguruar përgjegjësinë e partive dhe të aktorëve të tjerë përpara elektoratit.

Fokusi në komunikimin politik: Komunikimi politik me elektoratin është i nevojshëm për vendimmarrje të informuar dhe për të ruajtur besimin e publikut. Komunikimi i vendimeve programore, mënyra se si ato do të përmirësojnë jetën e qytetarëve, në kurriz të fushatave të zeza, dezinformimit, "sulmit" të ndërsjellë, është me rëndësi thelbësore për dalejn e elektoratit që nuk është pjesë e bazave partiake.

Komunikimi politik i socializon qytetarët për proceset zgjedhore në mënyrën se si ata vlerësohen dhe respektohen, votën që ata e japin për aktorët politikë përmes konsistencës së zotimeve, vizioneve të politikave që janë theksuar dhe janë elaboruar gjatë fushatës.

Respektimi i institucioneve demokratike: Aktorët politikë duhet të demonstrojnë një respekt të qartë për parimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e gjyqësorit dhe autoritetin e organeve zgjedhore, pasi ata kanë kapacitetin për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor. Nëpërmjet respektimit të institucioneve demokratike dhe veprimit politik që synon kontrollin demokratik, ngrihen standardet e qeverisjes demokratike, duke kontribuar kështu në rritjen e besimit të personat që janë kandidatë për poste publike.

Inkluziviteti dhe përfaqësimi: Partitë dhe kandidatët duhet të synojnë ta përfaqësojnë diversitetin e shoqërisë, duke siguruar se të gjithë zërat dëgjohen dhe vlerësohen në arenën politike.

Përkushtimi për tranzicion paqësor të pushtetit: Përpjekja për një transferim paqësor demokratik të pushtetit, pavarësisht nga rezultatet e zgjedhjeve, është me rëndësi jetike për stabilitetin dhe kontinuitetin e qeverisjes demokratike.

Partitë politike dhe kandidatët janë të thirrura t'i pranojnë parimet e politikës së virtytshme – përkushtimin për udhëheqje etike të bazuar në integritet, llogaridhënie dhe shërbim që synon të mirën publike. Duke mishëruar këto vlera, ato mund të frymëzojnë besim dhe të rrisin më tej cilësinë e diskursit politik.

Përmes një shqyrtimi rigoroz të sjelljes së partive politike dhe të kandidatëve presidencialë, ky udhëzues synon të japë rekomandime për promovimin e sjelljes etike në procesin zgjedhor me synim forcimin e demokracisë dhe avancimin e interesit publik të shtetit.

1. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në këtë analizë bazohet në ndjekjen e diskursit publik siç perceptohet nga qytetarët, gjegjësisht përmes mediave të disponueshme për ta.

Analiza përqipet të vlerësojë dimensionet etike të fushatave, duke përfshirë veprimet, synimet, qëndrimet, vendimet dhe premtimet e artikuluar nga partitë politike dhe kandidatët për president. Analiza komparative, nga ana tjetër, bazohet në njohuri nga përvojat ndërkombëtare dhe praktikat më të mira në etikën zgjedhore, duke mundësuar një kuptim kontekstual të dinamikës së jetës politike parazgjedhore në Maqedoninë e Veriut.

Perspektiva qytetare: Zgjedhja e perspektivës së qytetarit është pika qendrore e këtij hulumtimi. Duke pasur parasysh se ngjarjet partiake (mitingjet, mbledhjet partiake, komunikimi i brendshëm në vetë partitë) zakonisht ndiqen nga anëtarët dhe simpatizantët e partisë të clët kanë mundësi t'i ndjekin deklaratat e kandidatëve, pjesa tjetër e qytetarëve e bazojnë vendimin e tyre në përputhje me shkrimet, artikujt dhe komentet e prezantuara të marra përmes mediave tradicionale dhe rrjeteve sociale.

Duke analizuar këto të fundit, kjo qasje mundëson një kuptim të nuancuar të bazave etike të procesit zgjedhor, si dhe të dilemave etiko-politike me të cilat përballet çdo qytetar potencial në ditën e zgjedhjeve.

Të dhënat kërkimore dhe burimet: Analiza mbështetet nga një bazë e gjerë të dhënash, që përfshin **1647 artikuj gazetareskë**, video kontribute dhe tekste kanalesh në rrjetet sociale të kandidatëve, duke përfshirë edhe një krahasim të pjesshëm me programet e partive politike. Kjo bazë të dhënash mbulon një gamë të larmishme mediash, pra **69 media të ndryshme**, siguruar një spektër të gjerë pozicionesh dhe perspektivash.




Duke krahasuar mesazhet politike të dërguara nga kandidatët përmes kanaleve të tyre të komunikimit, si dhe mesazhet bartëse të partive të pranishme në mediat elektronike tradicionale, analiza synon të vlerësojë rolin e medias në formësimin e diskurseve dhe perceptimeve publike gjatë fushatës, gjegjësisht atë që media zgjedh t'ia shfaqë publikut.

Të dhënat e përgjithshme për analizën: nga 1647 postime të analizuar, 1012 bien në kategorinë e Etikës zgjedhore, 456 në kategorinë Ofertë programore, 80 në kategorinë e Kulturës së kompromisit politik, 64 në Debatin publik, 32 në Antikorrupsion dhe 3 në Transparencë. Tekstet gazetareske përfshijnë artikuj për të gjithë kandidatët presidencialë, të gjitha partitë politike, institucionet, analizat gazetareske dhe kolumnat. Në analizë nuk janë përpunuar intervista dhe emisione televizive, por janë përpunuar artikuj gazetareskë që dalin nga intervistat dhe emisionet televizive.


*Aneks 1: Lista e mediave publikimet mediatike të të cialve janë shfrytëzuar për bazën e të dhënave




Tabela kumulative



Nga gjithsej 1647 postime, 91% ose 1507 janë postime mediatike ndërsa 9% ose 140 janë postime në rrjetet sociale të kandidatëve për president, të cilat janë shfrytëzuar për krahasim ndërmjet mesazheve që propagandojnë vetë kandidatët dhe mesazheve që mediat zgjedhin t'i prezantojnë për ta.



Gradacioni i vlerës së publikimeve



Parametrat e analizës: Analiza mbështetet në përmbledhjen e parametrave të krijuar për të sqaruar aspektet kryesore të etikës zgjedhore. Ato janë:

1. **Mesazhi kryesor politik:** Identifikimi i mesazhit primar të përcjellë nga secili kandidat, duke përfshirë tonin dhe fokusin e tij. Prej këtij aspekti rezulton edhe vlerësimi se pse kandidatët përdorin parësisht mesazhe pozitive dhe negative në fushatat e tyre.
2. **Fokusimi në oferta ose sulme:** Vlerësimi nëse kandidatët e kanë si prioritet ta promovojnë agjendën e vet dhe ofertën e tyre politike ose parësisht të sulmojnë kundërshtarët politikë.
3. **Retorika politike (manipuluese) kundrejt mesazheve programore:** Ekzaminimi nëse kandidatët theksojnë retorikë (manipuluese) politike apo propozime thelbësore për politikën programore në komunikimet e tyre.
4. **Programi/oferta politike:** Vlerësimi i propozimeve dhe programeve të politikave të paraqitura nga kandidatët për t'iu përgjigjur nevojave dhe shqetësimeve të palëve të interesuara.
5. **Kultura e kompromisit politik:** Analiza e shkallës deri ku kandidatët tregojnë gatishmëri për të kërkuar kompromise dhe dialog me kundërshtarët politikë.
6. **Evoluimi i pikëpamjeve politike:** Ekzaminim nëse pozicionet dhe qëndrimet e kandidatëve pësojnë ndryshime apo zhvendosje gjatë fushatës, gjegjësisht cila është konsistenca e mesazheve të tyre politike.
7. **Mobilizimi i votave kundrejt demobilizimit:** Vlerësimi nëse kandidatët fokusohen në mobilizimin e mbështetjes së kandidaturës ose demobilizimit të mbështetjes së kundërshtarëve
8. **Prania e debatit politik:** Ekzaminimi nëse kandidatët janë të përfshirë në debate dhe diskutime thelbësore politike dhe nëse ata në përgjithësi marrin pjesë në debate të organizuara politike.
9. **Dezinformacione:** Identifikimi i rasteve kur kandidatët ndajnë informacione të rreme ose mashtruese me elektoratin.
10. **Përdorimi i fushatës negative/të zezë:** Vlerësim nëse kandidatët lëshohen në fushata negative ose taktika ad hominem për të nxirë kundërshtarët.

2. KONTEKSTI POLITIK I ZGJEDHJEVE TË VITIT 2024 DHE MODELET E SJELLJES SË VOTUESVE DHE PARTIVE/KANDIDATËVE

Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare po zhvillohen në fonin e ngjarjeve dhe sfidave të shumëanshme që, deri diku, e krijojnë edhe qëndrimin e çdo qytetari për dinamikën e brendshme shoqërore. Maqedonia e Veriut ka bërë hapa të rëndësishëm drejt konsolidimit demokratik, duke përfshirë zgjidhjen e kontesteve shumëvjeçare që çuan në përparimin e vendit drejt integritimit euroatlantike, gjë që rezultoi me anëtarësimin në NATO në vitin 2020.

Megjithatë, çështjet e pazgjidhura në domenin e ushtrimit të pushtetit, si korrupsioni, instrumentalizimi i çështjeve etnike dhe pamundësia e qytetarëve për realizimin e të drejtave të tyre themelore, vazhduan të paraqesin pengesa serioze për progresin demokratik të shtetit. Tensionet ndërmjet disa shteteve në rajon, si dhe lufta në Ukrainë e cila ka reperkusione të caktuara edhe në rajon, i bënë këto zgjedhje akoma më të rëndësishme për të ardhmen e vendit dhe rajonit.

Konteksti global

1.Lufta në Ukrainë: Lufta në Ukrainë shërben si një kujtesë kthjelltëse për pasojat potenciale nga konfliktet e pazgjidhura në rajon. Shembuj komparativ nga shtetet e tjera post-sovjetike si Gjeorgjia dhe Moldavia, si dhe konflikti në Gaza, nxjerrin në pah sfidat dhe implikimet e tensioneve gjeopolitike në stabilitetin rajonal.

2.Kriza ekonomike në Evropë: Kriza ekonomike në Evropë, e cila filloi me pandeminë, vazhdoi me krizën energjetike dhe të ushqimit, ka implikime të gjera në ekonomi, mirëqenien e përgjithshme publike dhe stabilitetin e Maqedonisë së Veriut, duke marrë parasysh rezistencën e dobët të ekonomisë maqedonase përballë sfidave të jashtme.

3.Rritja e populizmit politik: Rritja e populizmit në nivel global është sfida kryesore për institucionet demokratike. Shembuj komparativ të vendeve si si Franca, Italia, Gjermania, Holanda, Sllovakia, Hungaria apo Polonia dhe vendet fqinje, përvijojnë qartë strategjitë e përdorura nga liderët populistë dhe ndikimin e tyre të padyshimtë në rezultatet e zgjedhjeve.

4.Rritja e anti-establishmentit dhe partive euroskeptike: Shfaqja e anti-establishmentit dhe partive euroskeptike në Evropë, duke përqafuar populizmin në rritje, pasqyrojnë një zhgënjim më të gjerë nga partitë politike tradicionale dhe institucionet politike.

5.Polarizimi në rritje në shoqëritë: Pjesërisht si rezultat i ndikimit të strategjive populiste anti-establishment, në mënyrë të pashmangshme zgjerohet hendeku dhe rritet polarizimi në shoqëritë. Polarizimi i këtillë, rregullisht përjeton kulminacionin në kohë të zgjedhjeve. Duke pasur parasysh se viti 2024 është një "vit zgjedhor" global me 64 zgjedhje në të cilat vendosin mbi 2 miliardë njerëz (përfshirë Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rusinë dhe Indinë), gati gjysma e popullsisë së botës do t'i ekspozohet një polarizimi të fuqishëm, të forcuar në mënyrë plotësuese edhe nga algoritmet e rrjeteve sociale.

Konteksti global ndikon te qytetarët/votuesit për shkak të ndjeshmërisë së tyre ndaj sigurisë dhe perspektivave ekonomike, duke u dhënë përparësi kur votojnë për tema dhe ndjenja që përfshijnë qëndrime kundër imigracionit, nacionalizëm të theksuar apo euroskepticizëm.

Ndërkaq, nga ana tjetër, konteksti global në mënyrë reversivile ndikon edhe mbi partitë politike dhe kandidatët përmes përshtatjes së platformave dhe mesazheve si përgjigje ndaj tendencave globale, d.m.th. rritjes së populizmit të krahut të djathtë, miratimit të retorikës populiste ose nacionaliste për t'u bërë më tërheqës për një strukturë të caktuar demografike elektorale, si dhe pozicionim politik kundrejt zhvendosjeve të mëdha gjeopolitike (retorika anti-NATO, retorika pro-ruse, retorika e neutralitetit dhe multilateralizmit, etj.).

Konteksti rajonal

1. Marrëdhëniet Serbi-Kosovë: Tensionet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës në lidhje me statusin përfundimtar të Kosovës kanë rrënjë historike dhe implikime gjeopolitike dhe paraqesin një rrezik potencial për Ballkanin Perëndimor, përfshirë Maqedoninë e Veriut, e cila kufizohet me të dy vendet.

2. Tensionet politike në Bosnje e Hercegovinë: Tensionet politike në Bosnje e Hercegovinë e theksojnë kompleksitetin e qeverisjes pas konfliktit dhe marrëdhënieve ndëretnike. Edhe pse BeH nuk është fqinj i drejtpëdrejtë i Maqedonisë së Veriut, jehona politike dhe shkeljet gjeopolitike ndikojnë në thellimin e ndjenjës së pasigurisë në mesin e qytetarëve të Maqedonisë. Rasti aktual me rezolutën për Srebrenicën, është vetëm shembulli i fundit i tillë.

3. Rritja e partive nacionaliste, anti-establishment dhe populiste: Ngritja e partive nacionaliste, anti-establishment dhe populiste në rajon, pasqyrojnë tendenca më të gjera në Evropë dhe në botë. Edhe pse ato ende kanë një ndikim të rëndësishëm në politikën qeveritare, këto tendenca janë të dukshme edhe në Maqedoninë e Veriut me rritje të partive të cilat janë hapur euroskeptike, ndërsa në diskursin publik ndikojnë në rënien e mbështetjes për BE-në dhe NATO-n, gjë që nxit flirtin e partive të majta dhe të djathta demokratike me retorikën e dëmshme e cila mendojnë se do t'u sigurojë atyre një basen më të madh votash.

Konteksti rajonal ndikon të qytetarët/votuesit përmes ankthit të shtuar për sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe i mobilizon në bazë etnike dhe në bazë të agjendave rajonale etnike ose joetnike ("Platforma e Tiranës", "Platforma e Kosovës", Ballkani i Hapur, rezoluta për Srebrenicën, etj.) si dhe në zhvillimin e qëndrimeve paternaliste sidomos në raportin Shqipëri-Kosovë dhe Serbi. Nga ana tjetër, ndikon të partitë politike dhe kandidatët për president, përmes pranimit të qëndrimeve që lidhen me marrëdhëniet me fqinjët dhe të drejtat e minoriteteve dhe mundësi të ndikojë në konkurrencën partiake dhe strategjitë për ndërtim të koalicioneve me parti populiste.

Konteksti i brendshëm i vendor

1. Bllokada e procesit të integrimit evropian të Maqedonisë së Veriut nga Bullgaria: Bllokada e procesit të integrimit evropian të Maqedonisë së Veriut nga Bullgaria, nxjerr në pah kompleksitetin e diplomacisë rajonale dhe marrëdhënieve dypalëshe. Aktorët politikë pjesëmarrës në fushatën zgjedhore, kanë kundërshtime rrënjësisht kundërthënëse për këtë çështje, dhe kjo në masë të madhe e definon vetë fushatën zgjedhore.

2. Ngjarjet e mundshme negative në perspektivë me Greqinë: Thirrjet për tërheqje nga Marrëveshja e Prespës nga disa parti dhe organizata që po fitojnë në intensitet gjatë fushatës zgjedhore presidenciale dhe parlamentare, kërcënojnë t'i minojnë më tej marrëdhëniet dypalëshe dhe të kthejnë zhvillimin e arritur pas tri dekadash konflikti.

3. Ndikimet malinje nga palët e treta: Ndikimet malinje nga palët e treta përmes kanaleve tradicionale të mediave sociale minojnë anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO dhe stabilitetin demokratik të institucioneve.

4. Polarizimi politik dhe ideologjik dhe përkeqësimi i marrëdhënieve ndëretnike: Polarizimi i fuqishëm politik dhe sfidat për zhvillimin e marrëdhënieve ndëretnike paraqesin rreziqe për stabilitetin dhe qeverisjen demokratike të shtetit. Ndarja e thellë në baza etnike, si dhe ndarjet brendaetnike (patriotë-tradhtarë, BE-anti-BE, Edi Rama-Albin Kurti, Perëndim-Rusi etj.) pparaqesin një agjens të fuqishëm mobilizues në periudhën parazgjedhore.

5. Klima mediatike: Klima mediatike në të cilën vërehet një mungesë e dukshme e përfaqësimit të interesit publik demokratik përmes nxitjes së pjesëmarrjes së lartë në zgjedhje, ka ndikim demotivues për qytetarët për të dalë në votime. Për më tepër, është edhe gara për të rritur lexueshmërinë/shikueshmërinë përmes lajmeve sensacionale dhe negative.

6. Korrupsioni: Matjet ndërkombëtare të shkallës së korrupsionit dhe sundimit të ligjit, si dhe pamundësia e qytetarëve për të ushtruar të drejtat e tyre elementare, e pozicionojnë korrupsionin si temë të nxehtë. Tema është e pranishme edhe në eterin mediatik, kështu që në atmosferën parazgjedhore është përdorur dhe kontribuon në mobilizimin e votave.

7. Partizimi: Partizimi i rrënjësor thellë në çështjet dhe institucionet ushtarake është një problem po aq i rëndësishëm që duhet zgjidhur paralelisht me korrupsionin.

8. Ndikimet e aktorëve të tjerë vendas: Ciklet zgjedhore janë një periudhë e mjedisit politik për të gjithë aktorët dhe ata kanë interes nga epilogu i zgjedhjeve. Në këtë kontekst, është i dukshëm aktiviteti i institucioneve fetare, të cilat, duke cënuar rëndë karakterin sekular të shtetit dhe principet dhe parimet e veta shpirtërore, u kyçën në fushatat parazgjedhore të partive.

Konteksti i brendshëm vendas ndikon në sjelljen e qytetarëve/votuesve në më shumë drejtime. Një prej tyre është zhgënjimi dhe frustracioni i qytetarëve për shkak të të perspektivës së paqartë evropiane. Për më tepër, ekziston edhe besimi i thyer në institucionet demokratike dhe procesin zgjedhore dhe demotivim për të marrë pjesë në zgjedhje. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është relativizimi dhe cenimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, Marrëveshjes së Prespës për fqinjësi të mirë me Bullgarinë, e cila mund të ndikojë ndjeshëm në përkeqësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe ta formësojnë perceptimin e qytetarëve para zgjedhjeve.

Nga ana tjetër, konteksti i brendshëm vendas ndikon në sjelljen e partive politike në drejtim të euroskepticizmit të theksuar në fushatë dhe mobilizimin e ideve dhe platformave programore të një lloji tjetër integrimesh alternative (BRICS, Rusi-Kinë, integritime rajonale në baza etnike, etj.). Ky ndikon edhe në polarizimin etnik në rritje për të tërhequr më shumë vota “etnike”. Përfundimisht, ky ndikon edhe mbi retorikën kundër korrupsionit përmes dezavumit dhe delegjitimitit të kundërshtarit politik dhe fokusimit në një fushatë negative që synon të demotivojë votuesit potencial nga kampi kundërshtar, duke galvanizuar njëkohësisht bazën e ngurtë partiake.

3. ANALIZA E SJELLJES SË KANDIDATËVE PËR PRESIDENT

Zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut në vitin 2024 u karakterizuan për nga oferta e larmishme politike si dhe nga numri i madh i kandidatëve presidencialë të cilët pretenduan postin nominalisht më të lartë në shtet.

Megjithatë, përputhja e zgjedhjeve presidenciale me ato parlamentare, padyshim që ndikoi në dinamikën e këtyre zgjedhjeve dhe ato ishin shumë më tepër të përqendruara në temat që janë në kompetencë të Qeverisë sesa në temat që lidhen me kompetencat konkrete të presidentit. Si rrjedhojë, votuesit zgjedhjen e tyre shumë më tepër mundën ta ndërtojnë mbi bazën e politikave të partive që mbështesin kandidatët për president sesa në programet e vetë kandidatëve. Konstelacioni i këtillë mundësonte që partitë politike dhe vetë kandidatët për president të gjenin strategjinë më produktive për të tërhequr sa më shumë votues. Nga ana tjetër, përputhja e zgjedhjeve dhe mesazhet që dërgoheshin, ndikonin në hutinë e votuesve në kuptim të ndarjes të paqartë të ingerencave të postit president kundrejt ingerencave të qeverisë.

Në këtë analizë, hyjmë thellë në sjelljen e kandidatëve presidencialë bazuar në të dhënat e shumta të mbledhura nga performancat e tyre parazgjedhore dhe mesazhet parazgjedhore, analizë e sloganeve kryesore, trajtimi i medias ndaj kandidatëve si dhe marrëdhëniet e ndërsjella mes kandidatëve gjatë kohës së fushatës.

Kjo analizë synon të ofrojë një kuptim të nuancuar të dinamikës së zgjedhjeve presidenciale, duke u mundësuar palëve të interesuara të kuptojnë implikimet e sjelljes së kandidatëve mbi trajektoren e ardhshme dhe qeverisjen demokratike të vendit.

Profili ideologjiko-programor i kandidatëve për president

Stevo Pendarovski: Si president aktual dhe kandidat i propozuar nga LSDM-ja, Pendarovski në fushatën e tij u përpoq të projektojë vazhdimësi dhe stabilitet në qeverisje. Orientimi i tij pro-evropian dhe pro-NATO si dhe bashkëpunimi i fuqishëm rajonal lidhen me politikën kryesore të partisë e cila e propozon, duke theksuar rëndësinë e integriteteve evropiane dhe partneriteteve transatlantike për të ardhmen e Maqedonisë së Veriut. Qëndrimet e moderuara politike të Pendarovskit janë evidente, derisa slogani "Presidenti ynë Stevo" e pozicionon Pendarovskin si një njeri që i njeh qytetarët dhe që ua ngjall besimin, duke promovuar një shoqëri që nuk është vetëm e maqedonasve etnikë. Prapëseprapë, për dallim nga zgjedhjet paraprake presidenciale në vitin 2019, kur Pendarovski ishte kandidat i përbashkët i LSDM-së dhe BDI-së, në këto zgjedhje doli i vetëm si kandidat i LSDM-së. Kjo ndoshta edhe e shpjegon faktin se fushata e tij ishte proporcionalisht më shumë e përqendruar tek votuesit maqedonas dhe vërehej një qasje e pabalancuar ndaj pjesës tjetër të grupeve etnike. Nga ana programore, Pendarovski fliste për vetëqendrimin në gjyqësor dhe shfrytëzimin më të mirë të fondeve perëndimore dhe kundërshtoi propozimin që presidenti në të ardhmen të zgjidhet në Kuvend. Ndonëse kjo e fundit është diçka me të cilën u pajtuar me kandidaten Siljanovska-Davkova, megjithatë dialogu i tyre si kandidati të vetëm në raundin e dytë ishte i ashpër, pothuajse armiqësor.

Gordana Siljanovska-Davkova: Si kandidate e partisë më të madhe opozitare VMRO-DPMNE, Siljanovska-Davkova mban një qëndrim të hapur kritik ndaj politikave të koalicionit qeverisës, duke u angazhuar për integrimin e Maqedonisë së Veriut në BE dhe NATO, por me një sërë kushtëzimesh të cilat reflektohen në qasjen e saj ndaj çështjeve të tilla si ndryshimet kushtetuese dhe marrëdhëniet Maqedonisë së Veriut me shtetet fqinje. Mesazhi kryesor për anëtarësimin në BE ishte nevoja e rinogocimit të "propozimit francez", kundërshtimi për përfshirjen e komunitetit bullgar në Kushtetutë, si dhe premtimi se nuk do ta përdorë fjalën "e veriut" pasi ajo të bëhet presidente. Megjithatë, Siljanovska-Davkova pa mëdyshje angazhohet për përmbushjen e standardeve të NATO-s në sektorin e sigurisë. Slogani i Siljanovska-Davkovës, "Maqedonia përsëri krenare", apelon në ndjenjat kombëtare të qytetarëve dhe asocion në kthimin në një kohë të kaluar, ndonëse kjo e fundit u mohua disa herë gjatë fushatës. Nota e saj etno-nacionale në fjalimet e saja, edhe pse të kamufluara pjesërisht, si dhe retorika e vazhdueshme negative (vende vende edhe denigruese) ndaj kundërshtarit politik Pendarovski, në përputhje me narrativën tipike të krahut të djathtë të huazuar nga parti apo kandidatë të tjerë të djathtë në Evropë dhe SHBA. Siljanovska-Davkova adresoi pyetje nga sfera ndëretnike, të cilat janë pjesë e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MKO) dhe ligjet që dalin nga kjo marrëveshje, me qëllim të ridefinimit në drejtim të reduktimit të tyre. Ajo gjithashtu paralajmëroi se do t'i amnistojë personat e dënuar për ndërhyrje në Kuvend më 27 prill të vitit 2017. Evidente është teza e Siljanovska-Davkovës se narrativa politike "një shoqëri për të gjithë" është e gabuar dhe se e mjegullon realitetin e shoqërisë maqedonase. Siljanovska-Davkova njëherit premtonte reduktimin e numrit të deputetëve dhe ministrive në Qeveri.

Stevço Jakimovski: Duke përfaqësuar partinë "Grom", Jakimovski mban një qëndrim të qartë skeptik ndaj anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE dhe NATO, duke theksuar nevojën për zhvillimin e marrëdhënieve me vendet e tjera jashtë Evropës dhe Korpusit Euro-Atlantik, me kundërshtim të hapur ndaj ndryshimit të Kushtetutës për futjen e komunitetit bullgar në të, derisa të mbyllen çështjet e hapura për BE-në. Përmes sloganit zgjedhor "Guximshëm për Maqedoninë", Jakimovska në mënyrë delikate u përpoq të pozicionohej si lider i përgatitur për të sfiduar kursin e vendosur euroatlantik të shtetit duke avokuar për një partneritet të ri strategjik, i cili ishte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me shtetin euroatlantik përmes angazhimit për kërkim të partneriteteve të reja të cilat janë në konflikt të hapur me angazhimet euroatlantike të shtetit. Restartimi i fabrikave të armëve, rritje drastike e pensioneve, heqja e balancuesit, si dhe fundi i politikës lëshuese ndaj Bullgarisë dhe ndaj BE-së, ndryshime në delegimin e anëtarëve të këshillave gjyqësorë të Këshillit Gjyqësor Republikan dhe në Gjykatën Kushtetuese, janë pjesë e gamës së premtimeve të tij parazgjedhore.

Bujar Osmani: Si kandidat i Frontit Evropian të udhëhequr nga BDI, Osmani në qendër të fushatës së tij zgjedhore vuri përvojën e tij si ministër i Punëve të Jashtme dhe, ndër të tjera, si kryetar i OSBE-së, i cili kaloi me sukses krizën rreth zgjedhjes së një kryetar të ri. Në paraqitjet e tij, ai u përpoq të ruante një orientim të qartë pro-evropian dhe pro NATO-s. Edhe pse ka pasur një përpjekje për të komunikuar me votuesit maqedonas, duke i bindur ata se integrimet euroatlantike janë në favor dhe në funksion të mbrojtjes së identitetit etnik maqedonas, megjithatë, fushata e Osmanit ishte e fokusuar kryesisht tek votuesit etnikë shqiptarë, pothuajse në të njëjtin proporcion si atë të Stevo Pendarovskit përballë votuesve shqiptarë. Një theks i fortë në fushatë iu vu Rusisë dhe kultivimit të ndjenjave anti-ruse. Në fund të fushatës, Osmani intensifikoi retorikën e tij për forcimin e ndjenjave kombëtare shqiptare dhe hyri në një konflikt verbal të drejtpërdrejtë me Arben Taravarin se kush është përfaqësuesi i vërtetë i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, duke theksuar se BDI është përgjegjëse për "institucionalizimin" e popullit shqiptar në vend. Gjithashtu, Osmani pati një konflikt të hapur edhe me Hristijan Mickoskin, duke e quajtur shovinist sloganin e VMRO-DPMNE-së "Maqedonia përsëri e juaja". Osmani në fushatë ka kundërshtuar vazhdimisht heqjen e balancuesit dhe ka promovuar propozimin për zgjedhjen e presidentit në Kuvend. Ai ka shpallur falje për rastin "Alfa".

Slogani "Përvojë, sinqeritet dhe përkushtim" synon ta projektojë Osmanin si një politikan me përvojë dhe me përkushtim të vërtetë ndaj interesave të shtetit.

Biljana Vankovska: Vankovska përfaqëson partinë "E Majta", e cila, përkundër pozitës së saj të shpallur radikale të majtë në spektrin politik, njihet njësoj edhe si parti që kultivon pikëpamje të djathta. Në fushatën e saj, Vankovska mban një qëndrim kritik ndaj anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE dhe NATO.

Qëndrimi i saj kritik ndaj marrëdhënieve të Maqedonisë së Veriut me Bullgarinë dhe Greqinë thekson dëshirën për të sfiduar narrativat tradicionale për të realizuar drejtime alternative në drejtim të politikës së jashtme të Maqedonisë, me një tregues të qartë se vendi duhet të përpiqet të bëhet pjesë e BRICS. Slogani i Vankovskës, “Po ia kthejmë dinjitetin kombit”, depërton në ndjenjat populiste të qytetarëve duke premtuar zgjidhjen e padrejtësive dhe pabarazive të perceptuara dhe premtim të vendosur ndaj institucioneve ndërkombëtare dhe këmbëngulje për reciprocitet.

Gjatë fushatës, Vankovska mbrojti ndryshimin e kushtetutës dhe futjen e një kushtetute sociale dhe jo etnike, në mënyrë që pikëpamjet e saj të lëviznin më pas në drejtim të një kushtetute civile. Vankovska ishte ashpër kundër ndryshimeve kushtetuese për futjen e komunitetit bullgar dhe mbrojti heqjen ose rishikimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, Marrëveshjes së Prespës dhe Marrëveshjes për fqinjësi të mirë me Republikën e Bullgarisë. Zvogëlimi i buxhetit ushtarak në kurriz të buxhetit të arsimit si dhe mbështetja e hapur për pranimin e mundësive ekonomike të ofruara nga Kina, ishin gjithashtu pjesë e fushatës zgjedhore të Vankovskës.

Arben Taravari: Si kandidat i opozitës shqiptare VREDI, Taravari mbajti një orientim të qartë pro-evropian dhe pro NATO-s gjatë fushatës, por fushata e tij u fokusua kryesisht në rëndësinë e ndryshimeve në pushtetin qendror në vend. Slogani i Taravarit “Ndryshimi Vlen” nuk synonte aq shumë mandatin e presidentit apo kursin e politikës së jashtme në kuadër të integriteteve evropiane, por synonte të nënvizonte angazhimin e tij dhe të koalicionit që mbështeti kandidaturën e tij në drejtim të reformave të brendshme dhe zhvillimit të përgjithshëm të vendit. Taravari shpalli falje për ato rastet që i konsideronte si “të inskenuara politikisht” si rasti “Monstra” apo “Alfa”. Fushata presidenciale e Taravarit ishte kryesisht në funksion të zgjedhjeve parlamentare në mbështetje të koalicionit VLEN. Prandaj, mesazhet dhe premtimet që iu dërguan elektoratit ishin kryesisht jashtë kompetencave të presidentit. Formimi i një trupi ekspertësh të huaj që do të kontrollonin gjyqtarët në punën e tyre, ndalimi i lojërave të fatit dhe kredive të shpejta, paga minimale 800 euro, si dhe barazimi i gjuhës shqipe me maqedonishten në përdorimin e saj, janë vetëm pjesë e premtimeve parazgjedhore. premtime që nuk i përkasin kredencialeve të presidentit. Nga ana tjetër, Taravari kërkoi nga Maqedonia e Veriut të tërhiqet nga nisma e Ballkanit të Hapur dhe shprehu një afërsi të qartë me Albin Kurtin, veçanërisht në performancën para diasporës shqiptare.

Maksim Dimitrievski: Dimitrievski si kandidat i partisë “ZNAM” e përkrah orientimin properëndimor të shtetit, por në të njëjtën kohë shfaq qëndrime të mprehta kritike ndaj tejkalimit të kontesteve me Bullgarinë dhe Greqinë, që është parakusht për zhbllokimin e procesit të integriteteve evropiane. Ai po ashtu mban qëndrim të hapur kritik edhe për politikën mbi tejkalimin e përçarjeve etnike në vend. Slogani i Dimitrievskit “Maksimumi për Maqedoninë” e implikon përkushtimin e tij të maksimizimit të pozicionit të Maqedonisë së Veriut në drejtim të realizimit të qëllimeve të saja në politikën e jashtme.

Gjatë fushatës, Dimitrievski i ofroi kryesisë së LSDM-së të japë dorëheqje dhe ofroi bashkëpunim në raundin e parë. Ai theksoi se do të angazhohet për përmirësimin e statusit të mbrojtësve (branitellave) të vitit 2001 dhe se epoka në të cilën BDI po ndërton një shoqëri bi-etnike, ka përfunduar. Angazhohet për heqjen e të gjithë çelsave dhe kuotave etnike dhe “rivendosjen e barazisë midis qytetarëve”. Në pjesën e sundimit të ligjit, Dimitrievski u anagazhua për departamentizimin e sektorit të sigurisë, ngritjen e të hyrave, zgjedhjen e prokurorit publik me propozim të opozitës, formimin e ekipit special dhe strategji për luftë kundër korrupsioni, heqjen e disa ministrive dhe uljen e numrit të deputetëve.

Përkushtimi në ofertën ose të sulmuarit e kundërshtarëve

Për shkak të kompetencave relativisht të kufizuara të presidentit të të Maqedonisë së Veriut, mund të pritët që fushatat zgjedhore pritët të jenë relativisht të qeta. Megjithatë, duke pasur parasysh se zgjedhjet presidenciale përkonin me zgjedhjet parlamentare, fushata ishte jashtëzakonisht dinamike, veçanërisht në segmentet që përfshinin liderët e partive, pasi arena presidenciale u zgjerua mes sulmeve të ndërsjella deri te fyerjet e rënda dhe degradimi i plotë i personalitetit të kandidatëve.

Gjatë fushatës, kandidatët Gordana Siljanovska-Davkova dhe Stevo Pendarovski kryesisht u fokusuan në prezantimin e platformave të tyre dhe angazhimin me votuesit, por te Siljanovska-Davkova është i pranishëm një sulm i vazhdueshëm ndaj Pendarovskit, i cili kryesisht konsiston me shkrirjen e tij me pushtetin aktual dhe diskreditimin e personalitetit të tij. Pendarovski, nga ana tjetër, sulmet e tij i ka pozicionuar drejtpërdrejt në drejtim të Siljanovska-Davkovës. Nga ana tjetër, vërehet lehtë se Stevço Jakimovski dhe Biljana Vankovska patën zëra kritikë në drejtim të drejtimeve strategjike, duke nxjerrë në pah mangësitë dhe duke avokuar qasje alternative. Te kandidatët tjerë, Bujar Osmani dhe Arben Taravari, vërehej se gjatë fushatës tregonin maturi në diskursin e tyre, e cila pas rrethit të parë eskaloi në sulm të ndërsjellë.

Fokusimi në mesazhe politike ose programore

Të gjithë kandidatët gjatë fushatës trajtuan edhe çështje politike që lidhen drejtpërdrejt me kompetencat e presidentit të shtetit. Kështu, Stevo Pendarovski dhe Bujar Osmani i dhanë prioritet mesazheve programore lidhur me procesin e integrimeve euroatlantike, si mënyra më e mirë për zgjidhjen e çështjeve të brendshme sistematike. Të tjerët, ndërkaq, si për shembull Gordana Siljanovska-Davkova, Stevo Pendarovski dhe Biljana Vankovska, më shumë u fokusuan në narrativet e tyre politike, përfshirë ato që lidhen me identitetin kombëtar dhe sovranitetin shtetëror. Arben Taravari, nga ana tjetër, vërehej se po përdorte fushatën për afirmimin e çështjeve më të gjera sistematike dhe zgjidhjen e deficiteve demokratike. Pa përjashtim, të gjithë kandidatët kishin një narrativë shumë më të theksuar politike sesa programore dhe shpesh përmendeshin shprehjet “babai i kombit” dhe “nëna e kombit”, me fokus të veçantë në ndjenjat intime të krenarisë, dinjitetit dhe rrezikut nga cenimi i identitetit.



Kulutra e kompromisit

Kandidatët Stevo Pendarovski dhe Bujar Osmani gjatë fushatës treguan gatishmëri për të kultivuar kulturën e kompromisit përmes përfshirjes në një dialog konstruktiv dhe për të promovuar qeverisje gjithëpërfshirëse. Të tjerët, si për shembull Gordana Siljanovska-Davkova dhe Arben Taravari, u shprehën të hapur për bashkëpunim me partitë e tjera, parësisht në drejtim të ballafaqimit me sfidat urgjente kombëtare. Kandidatët Stevço Jakimovski dhe Biljana Vankovska në fushatat e tyre treguan një qasje më konfrontuese me pothuajse të gjitha opsionet e tjera politike, diçka që mund të pengojë përpjekjet për ndërtimin e konsensusit politike dhe bashkëpunimit, të cilat janë të domosdoshme, veçanërisht në kontekst të fillimit të pritshëm të negociatave për anëtarësim në BE.

Ndryshim i qëndrimeve politike gjatë fushatës

Përederisa disa kandidatë mbetën në pozicione konsistente gjatë fushatës, të tjerët, siç është Maksim Dimitrievski, i përshtatnin mesazhet e tyre si përgjigje të dinamikës evoluese politike dhe preferencave të votuesve. Stevo Pendarovski dhe Gordana Siljanovska-Davko në masë të madhe u qëndruan besnik platformave të tyre fillestare, duke i konfirmuar mesazhet e tyre thelbësore dhe prioritetet e politikës. Bujar Osmani dhe Arben Taravari, ndërkaq, e theksuan rëndësinë e përshtatshmërisë dhe reagimin ndaj rrethanave të ndryshueshme, duke demonstruar fleksibilitet në strategjitë e tyre të fushatës.

Dezinformatat dhe fushata e zezë

Ndonëse sentimentet negativë ishin të pranishëm gjatë gjithë fushatës zgjedhore dhe kandidatët nuk u përmbajtën nga sulmet ndaj njëri-tjetrit, megjithatë fushatat e organizuara të zeza dhe dezinformuese munguan në diskursin publik në mediat tradicionale dhe elektronike, duke i lënë këto grupe të izoluara dhe të kufizuara në margjinat e profileve anonime në rrjetet sociale.

Konkluzioni në këtë pjesë çon në atë se kandidatët dominuan në animacionin dhe ballafaqimin e bazave partiake, të cilat qëndrojnë pas nominimit të kandidatëve. Pozicionimi i këtyre, së bashku me mungesën e mesazheve pozitive optimiste në eterin publik, bënë me dije se kandidatët në këto zgjedhje, aspak nuk i kishin në fokus qytetarët e papërcaktuar.

4. ANALIZË E SJELLJES SË PARTIVE POLITIKE PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Profili ideologjiko-programor i partive politike

Në zgjedhjet parlamentare morën pjesë 17 parti apo koalicione, por vetëm 6 prej tyre: VMRO-DPMNE dhe koalicioni, LSDM dhe koalicioni, BDI dhe koalicioni, VLEN, ZNAM dhe E majta, kishin retjtingje që premtojnë se do të hyjnë në parlament. Partitë tjera kishin rejting nën 1%.

Ndarja sipas bazës ideologjike është shumë e vështirë për shkak të profileve të paqarta të partive, por megjithatë mund të thuhet se VMRO-DPMNE e zë vendin qendror në anën e djathtë të spektrit politik, ndërsa LSDM përfaqëson pozicione të majta-centriste. ZNAM rrjedh nga spektri i majtë, por në disa aspekte profilizohet si parti e djathtë, ndërsa E majta, përveç se prezantohet si parti e majtë, merr pozicione tejet të djathta. Dy koalicionet, të cilat përfshijnë të gjitha partitë shqiptare, plus disa parti nga bashkësitë më të vogla etnike, vështirë se mund të vendosen në spektrin ideologjik për shkak të fokusit programor në çështjet etnike.

Përkushtimi në ofertë ose në të sulmuarit e kundërshtarëve

Oferta e kësaj fushate elektorale ishte nën hijen e një lufte politike që ishte e përqendruar në luftën për "Ndryshime", mesazh ky që ishte i kyçur në sloganin e VMRO-DPMNE-së dhe ishte edhe slogan kryesor i koalicionit VLEN, të cilin e përbënin partitë e shqiptarëve që pretendonin se ishin opozitare, ndonëse ato ishin pjesë e pushtetit në periudha të ndryshme të qeverive të udhëhequra nga LSDM në 7 vitet e fundit .

Oferta kryesore nga ana e LSDM-së dhe koalicionit "Fronti Evropian" i udhëhequr nga BDI-ja, i cili përfshinte 4 parti të shqiptarëve dhe disa parti më të vogla që përfaqësonin interesat e turqve, romëve dhe boshnjakëve në Maqedoninë e Veriut, ishte përqendruar rreth procesit të integritit në BE që filloi me Konferencën e parë ndërqeveritare në fillim të vitit 2023.

Nga dy partitë e mbetura, oferta e ZNAM-it u fokusua kryesisht në kritikimin e qeverisë për gjoja butësi ndaj shqiptarëve, si dhe për ngurtësinë e pamjaftueshme ndaj kërkesave të Bullgarisë si parakusht për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE. Partia E Majta, ngjashëm me ZNAM-in, ishte gjithashtu kritike ndaj qeverisë dhe gjoja butësinë e saj ndaj kërkesave të shqiptarëve, si dhe ngurtësinë e pamjaftueshme ndaj kërkesave të Bullgarisë në lidhje me përfshirjen e pakicës bullgare në Kushtetutë.

Mesazhet e lartpërmendura u përdorën si paradigmë për ndërtimin e sjelljes me kundërshtarët politikë, shpesh duke i shtrembëruar ato për të sulmuar kundërshtarin, me ç'rast caku kryesor i sulmeve ishin dy partitë që e përbënin boshtin kryesor të pushtetit në 7 vitet e fundit, gjegjësisht LSDM dhe BDI. Ndonëse në fillim pati sulme nga shumë anë dhe E Majta i sulmoi pothuajse të gjitha partitë, njoftoi VMRO-DPMNE shpalli "armëpushim" me të gjitha partitë opozitare me qëllim shembjen e LSDM-së dhe BDI-së, pra lufta politike u shndërrua në një front të gjerë politik ku më së shumti përfitoi VMRO-DPMNE.

Fokusi në mesazhet politike ose programore

Analiza e shkrimeve gazetareske, e artikujve televizivë dhe postimeve në rrjetet sociale të cilat dominuan në eterin publik, tregon se prania e mesazheve të përgjithshme politike, retorikës politike dhe sulmeve ndaj kundërshtarëve është dy herë më e madhe (1012 kundrejt 456) se artikujt që i referohen mesazheve programore, d.m.th. ofertat e kandidatëve apo partive. VMRO-DPMNE proporcionalisht është më e fokusuar në sulmet ndaj kundërshtarit, të cilat i plason kryesisht në mitingje të mëdha partiake. Kundërshtari në fillim të fushatës është LSDM-ja, por sulmi gradualisht shkon drejt BDI-së dhe në pjesën e dytë të fushatës, BDI bëhet kundërshtari i vetëm i VMRO-DPMNE-së, ndërsa LSDM-ja mbetet krejtësisht marginal. Nga ana tjetër, kur VMRO-DPMNE i prezanton mesazhet programore, ato janë të konkretizuara dhe kryesisht lokale dhe të destinuara për audiencë të veçanta që adresohen më së shumti gjatë vizitave në terren dhe ngjarjeve lokale.

LSDM i sulmon kundërshtarët proporcionalisht më pak krahasuar me përcaktimet programore, por komunikimi i tyre lidhet me vetë-promovimin e arritjeve të kaluara. Kur LSDM-ja promovon komunikim përcaktim të ardhshme programore, ato më shpesh janë vështirë të prekshme, përmbajnë abstraksion të lartë në të shprehurit dhe përgjithësisht janë fokusuar në tema mëdha që lidhen me BE-në. Në këtë rast, profili i audiencës dhe targetit të fushatës janë krejtësisht të paqarta.

Në betejën për të përfituar votuesin shqiptar, te BDI-ja dhe VLEN-i ekziston një retorikë komunikimi e ngjashme, vende-vende identike. Në fakt, të dy koalicionet përdorin në mënyrë dominuese të njëjtat mesazhe politike dhe fokusohen në sulmin ndaj kundërshtarit dhe në një masë të parëndësishme komunikojnë përcaktim e tyre programore. ZNAM-i dominon me mesazhe më konkrete programore me të cilat, ashiqare e mobilizon pakënaqësinë e grupeve specifike të cilat i identifikon në bazën partiake të LSDM-së dhe Të Majtës. Sulmi i ZNAM-it fokusohet kryekëput në koalicionin qeverisës. E Majta komunikimin e saj e redukton në mesazhe politike të cilat janë sulm kundër të gjitha partive politike, ndërsa për nga programi janë të orientuar drejt zgjidhjeve radikale. Kjo strategji duket se është e qendrisur pikësëpari për mobilizimin e anëtarësisë së vet, pavarësisht pamundësisë së zbatimit në praktikë të një pjese të madhe të zgjidhjeve radikale.

Kultura e kompromisit

Edhe pse thuajse të gjitha partitë janë pro integritimeve në BE, gjatë debatit për masat dhe hapat që duhet të ndërmerren për arritjen e këtij qëllimi, thuajse nuk pati asnjëfarë gatishmërie për të arritur kompromisin më të vogël, me çka do të hapej mundësia e bashkëpunimit mes partive në tejkalimin e pengesave në rrugën e hapjes së klasterave për anëtarësim në BE.

Përpijke për kompromis nuk pati as ndërmjet dy blloqeve të partive shqiptare, të cilat kishin objektiva shumë të ngjashme programore dhe politike. Në vend të kësaj, fushata zgjedhore u shndërrua në një luftë të zhveshur politike për pushtet, me ç'rast koalicionet e ardhshme u përcaktuan pavarësisht nëse platformat e tyre zgjedhore ishin komplementare apo të kundërta me njëra-tjetrën.

Ndryshimi i qëndrimeve politike gjatë fushatës

Partitë dhe koalicionet politike kryesisht mbetën në pozicionet e tyre fillestare politike, por rrjedha e fushatës solli ndryshime dhe manovra të caktuara, veçanërisht të blloku i partive opozitare. Taktikisht, këto manovra shërbenin për të zbutur sulmet e ndërsjella në emër të qëllimit të përbashkët për rrëzimin e partive në pushtet. Kjo e fundit sidomos ka të bëjë me ZNAM dhe VMRO-DPMNE. Nga ana tjetër, partia udhëheqëse në pushtet, LSDM-ja, në momente të caktuara sulmoi partnerin e saj afatgjatë në pushtet, BDI-në, duke u përpjekur në këtë mënyrë të zbusë sulmet e opozitës që shkonin në vijën se LSDM-ja ka qenë “tepër e butë” ndaj ambicieve të BDI-së.

Koalicioni VLEN, ndonëse në fillim angazhohej se duhet votuar së pari amendamentet kushtetuese për përfshirjen e pakicës bullgare në Kushtetutë, në pjesën e dytë të fushatës e relativizoi këtë qëndrim, me çka mori një ofertë të hapur nga VMRO-DPMNE për të qenë partner i saj në përbërjen e qeverisë pas fitores së pritshme zgjedhore.

Dezinformatat dhe fushata e zezë

Edhe pse sentimente negativ dhe retorika agresive zunë pozitën qendrore në zgjedhje, ndryshe nga ciklet e mëparshme zgjedhore, fushata e zezë dhe fushata me dezinformata nuk ishte aq e dukshme në mediat tradicionale, të shkruara apo elektronike.

Komunikimi negativ më së shumti u shfrytëzua nga partia më e madhe opozitare VMRO-DPMNE dhe pothuajse tërësisht u drejtua ndaj partisë më dominuese të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, BDI. Qëndrimi i VMRO-DPMNE-së, i publikuar që para fillimit të fushatës, e bëri të qartë se ajo nuk e dëshiron BDI-në në qeverinë e ardhshme dhe në çdo mënyrë u përpoq të ndikonte të votuesit shqiptarë në dobi të koalicionit VLEN, duke shfrytëzuar edhe klientelizmin si mjet për t'i orientuar këta votues. Këto sulme shpesh u kthyen në masë të njëjtë ose të ngjashme, me çka përplasjet politike ndërmjet këtyre partive i dhanë vulën më të fuqishme dhe më problematike këtij procesi zgjedhor. Ashpërsia e fushatës së këtillë anti-BDI, e cila nga shumë qytetarë dhe analistë u pa si antishqiptare, mund të ketë pasoja negative të gjera për marrëdhëniet ndëretnike në vend.

PERCEPTIMET PËRFUNDIMTARE

Zgjedhjet presidenciale parlamentare të vitit 2024 treguan se janë tejkaluar format më të rënda të parregullsive të pranishme në ciklet e mëparshme zgjedhore. Detyra e rëndësishme e cila pason ka të bëjë me ngritjen e standardeve demokratike dhe nxitjen e përgjegjësisë të bartësve të funksioneve publike që buron nga kompetencat origjinale të një posti konkret. Së këndejmi, analiza nxjerr disa konkluzione që mund të shërbejnë si një udhërrëfyes në të ardhmen për sjelljen e aktorëve politikë.

Për shkak të **gërshetimit të fushatave** dhe performancës së kandidatëve dhe liderëve të partive politike, është shumë e vështirë të nxirren përfundime të veçanta të cilat i dallojnë zgjedhjet presidenciale nga ato parlamentare. Prandaj, konkluzionet kryesisht u referohen të dyja fushatave.

1. Atmosfera politike në të cilën u mbajtën zgjedhjet tregon se fushatat po zhvillohen në një sentiment dominues negative i cili e vërshon hapësirën publike. Praktikohet nga të gjithë aktorët shoqërorë, duke filluar nga partitë politike dhe kandidatët, mediat, analistët, influencerët. Klima shoqërore në të cilën zhvillohen fushatat është e pafavorshme për qytetarët, gjegjësisht apelon pothuajse ekskluzivisht për mobilizimin partiak e jo qytetar. Gjatë fushatave, në publik mungon një debat thelbësor programor dhe plotësisht mungon dialogu midis aktorëve, gjë që kontribuon në polarizimin e fuqishëm.

2. Retorika agresive dhe fushata negative. Përdorimi i retorikës agresive dhe ngjallja e ndjenjave negative nga VMRO-DPMNE ndaj BDI-së, si dhe reagimi i BDI-së ndaj VMRO-DPMNE-së, flet për një trend shqetësues polarizimit në peizazhin politik të shtetit. Sidomos shqetëson tendenca për të megjulluar kufirin midis një sulmi ndaj një partie dhe një sulmi ndaj një grupi të tërë etnik. Retorika agresive gjatë fushatës ishte e pranishme te të gjitha partitë opozitare, të cilat edhe sikur të mos u përkasin grupeve të ndryshme etnike, e sulmonin sjelljen e “të vetëve” ndaj etnikumit tjetër në drejtim negativ. Sulmet e këtilla ishin veçanërisht të pranishme kundër LSDM-së në pushtet, duke e quajtur sjelljen e saj ndaj BDI-së (dhe në shtrirje ndaj shqiptarëve në përgjithësi) “nënshtrim dhe hyzmeqarllëk”. Këto taktika jo vetëm që e minojnë dialogun konstruktiv dhe kompromisin, por gjithashtu kanë potencialin të përkeqësojnë tensionet ndëretnike dhe ndarjet sociale. Në fushatë shënohet edhe lehtësia shqetësuese me të cilën partitë mobilizojnë vota “etnike” përmes retorikës që gjeneron tensione etnike. Pothuajse si rregull, pas përfundimit të fushatës parazgjedhore, votat e tilla në mënyrë subtile shndërrohen në një kulturë kompromisi politik, veçanërisht në kuadër të koalicionit të ardhshëm ose të supozuar qeverisës. Prapëseprapë, ky polarizim mbetet në mendjen e qytetarëve një kohë të gjatë dhe përfaqëson një potencial të fortë mobilizimi negativ për të ardhmen.

3. Pozicionimi i partive të reja dhe më të vogla. Pozicionet restriktive të miratuara nga partitë siç është partia "ZNAM" në lidhje me integrimet evropiane dhe marrëdhëniet dypalëshe me Bullgarinë, si dhe narrativi populist i partisë "E majta", e cila angazhohet për tërheqjen e Maqedonisë së Veriut nga NATO dhe për anulimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të 2017 dhe 2018, paraqesin sfida serioze për interesat strategjike të Maqedonisë dhe për qëllimet e politikës së jashtme, duke e komplikuar më tej peizazhin politik. Është shqetësuese që partitë më të vogla, të pangarkuara nga përgjegjësia e ushtrimit eventual të pushtetit, komunikojnë qëndrime problematike dhe radikale të cilat nuk janë përpunuar në publik. Mungesa e reagimit dhe përgjigjes ndaj ngjarjeve të tilla radikale, ndikon në perceptimin e qytetarëve në afat të gjatë, duke e zhvendosur kufirin demokratik drejt opsioneve dhe ofertave radikale politike.

4. Implikimet mbi zhvillimin e marrëdhënieve të Maqedonisë së Veriut dhe vendeve fqinje. Epilogu nga zgjedhjet kumton pesimizëm në marrëdhëniet e Maqedonisë së Veriut me vendet fqinje, kryesisht me Greqinë dhe Bullgarinë. Diskursi politike dhe retorika e fushatës i nxorën në pah tensionet dhe sfidat në marrëdhëniet diplomatike me këto vende, duke shkaktuar shqetësim për trajektoren e ardhshme të bashkëpunimit rajonal dhe përpjekjet për euro-integrim.

5. Kandidatët presidencialë janë të përkushtuar në mënyrë dominuese në theksimin e dobësive të kundërshtarit. Ata zbatuan strategji kundërtthënëse të cilat i pozicionuan në pozicione divergjente ideologjike, duke filluar nga orientimet pro-evropian dhe pro-NATO deri tek qëndrimet kritizere drejt integriteteve evropiane dhe anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare. Në të njëjtin drejtim lëviznin edhe zgjidhjet për sfidat gjeopolitike. Sjellja e kandidatëve presidencialë ndikoi në dinamikën e fushatës zgjedhore, formësimin të diskursit publik, perceptimet e votuesve dhe rezultatet e zgjedhjeve. Ndërveprimet e tyre me kundërshtarët, angazhimi me çështje kritike dhe efektiviteti i përcjelljes së mesazheve të tyre luajti një rol kyç në formësimin e peizazhit zgjedhor të Maqedonisë së Veriut. Tre nga gjithsej gjashtë kandidatë, përkatësisht Siljanoska-Davkova, Taravari dhe Osmani, paralajmëruan përdorimin e së drejtës për amnisti për rastin që solli tronditje të madhe në shoqërinë maqedonase, kontradiktore me deklaratat e tyre (dhe me deklaratat e partive të tyre) për sundimin e ligjit dhe gjyqsorit të pavarur. Tema për zgjedhjen e presidentit në kuvend dhe zhdukja e saj graduale nga diskursi publik, kur filluan të shihen në konturat e koalicionit të ardhshëm qeveritar, tregon se është shfrytëzuar si taktikë fillestare negociuese, e jo si shpërthim dhe nevojë autentike.

6. Komunikimi publik i partive gjatë zgjedhjeve parlamentare , përveçse është negativ, me diletantizëm politik dhe ie orientuar ekskluzivisht drejt bazave partiake, ajo u referohet edhe botëve krejtësisht të ndryshme.

Në aspektin programor, VMRO-DPMNE në komunikimin e saj publik përfaqëson tema lokale dhe të prekshme të cilat e anoncojnë fushatën për zgjedhjet lokale të vitit të ardhshëm, duke njoftuar me modesti vënie e politika ndërkombëtare në plan të dytë. Për dallim prej tyre, edhe LSDM edhe BDI komunikojnë kryesisht përmes temave të mëdha nga politika ndërkombëtare me fokus në eurointegrimin. Për më tepër, te BDI-ja fuqishëm është e shprehur politika etnike dhe statusi i shqiptarëve etnikë në kuadër të shtetit dhe shoqërisë. VLEN komunikimin e vet programor e bazon në ruajtjen e temave eurointegruese, por, ngajshëm me VMRO-DPMNE-në fokusohet në çështje specifike konkrete të brendshme që kanë të bëjnë me avancimin e agjendës etnike. Nga ana programore, ZNAM-i bën përjashtim nga sa më sipër, duke u fokusuar në temat lehtësisht ngjitëse politike dhe papërcaktueshmërinë ideologjike të përcaktimeve programore. Një pjesë e përcaktimeve programore të ZNAM-it janë kontradiktore me ato të partive që pretendojnë të formojnë një koalicion qeverisës, gjë që paraet "kurth" që për një kohë të shkurtër mund të zvogëlojë kredibilitetin e partisë. E Majta, duke mbrojtur qëndrimet antiperëndimore dhe zgjidhjet radikale programore, kryesisht fokusohet në mobilizimin dhe animimin e simpatizantëve të anëtarësisë.

7. **Mediat** shfaqin tendencë për të theksuar mesazhet negative dhe i paraqesin ato si parësore për qytetarët. Kandidatët presidencialë në profilet e tyre publike në rrjetet sociale rrezatojnë mesazhe më pozitive sesa ato që u përcillen nga ana e mediave. Në këtë mënyrë mediat kontribuojnë në klimën negative gjatë procesit zgjedhor. Nga ana tjetër, ndërkaq, në lidhje me zgjedhjet parlamentare vërehet një çekuilibër në përfaqësimin e partive, që ndoshta vjen si pasojë e mënyrës së marrejs me qira të hapësirës mediatike nga ana e partive. Në të dyja fushatat, mediat kontribuojnë për një atmosferë të tensionuar, negative parazgjedhore, në të cilën rrallë dalin lajme pozitive dhe atmosfera e tillë krijon kontekst demotivues për votuesit e potencialë. Mediat nuk i përpunojnë thelbësisht deklaratat problematike të kandidatëve, e njëherit nuk i kushtojnë kurrfarë vëmendje as profileve të kandidatëve sipas listave zgjedhore të partive politike.

REKOMANDIME PËR AVANCIMIN E PROCESËSVE ZGJEDHORE DHE DEMOKRATIKE

Zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në Maqedoninë e Veriut ofrojnë një mundësi të mirë për të vlerësuar gjendjen e demokracisë në vend.

Në dritën e konkluzioneve të nxjerra nga analiza zgjedhore, është e evidente se Maqedonia e Veriut përballet me sfida të rëndësishme në ruajtjen e stabilitetit demokratik, promovimin e harmonisë ndëretnike dhe respektimin e standardeve etike të sjelljes politike. Megjithatë, mes këtyre sfidave qëndrojnë mundësitë për të forcuar institucionet demokratike, për të nxitur dialogun gjithëpërfshirës dhe për të forcuar angazhimin qytetar. Aktorët politikë tani ballafaqohen me një vetëdije më të lartë qytetare se më parë dhe për këtë arsye duhet të jenë të kujdesshëm ndaj politikave kyçe të propozuara që lidhen me cilësinë e jetës së qytetarëve, pavarësisht nga baza e tyre partiake, etnike apo ndonjë bazë tjetër. Dialogu gjithëpërfshirës dhe nxitja e angazhimit qytetar do të jenë dy ndryshimet më domethënëse që do të kontribuojnë në rritjen e besimit tek institucionet publike nga qytetarët.

Rekomandimet e mëposhtme shërbejnë si një udhërrëfyes për politikëbërësit, institucionet, aktorët e shoqërisë civile dhe qytetarët për të promovuar demokracinë në Maqedoninë e Veriut.

Duke i pranuar këto rekomandime dhe duke u përkushtuar ndaj parimeve demokratike, Maqedonia e Veriut mund të kapërcejë pengesat ekzistuese dhe të ndërtojë një shoqëri demokratike më rezistuese dhe më prosperuese për gjeneratat e ardhshme. Krijimi i një baze të shëndetshme demokratike për brezat e ardhshëm, nënkupton edhe të rinj të edukuar që dinë t'i njohin dhe zbatojnë këto standarde demokratike.

Rekomandime për avancimin e proceseve demokratike zgjedhore

1. Zgjedhjet si “festë” për qytetarët e papërcaktuar. Përqindja e lartë e daljes në zgjedhje duhet të jetë imperativ.

Të gjithë aktorët politikë, institucionalë dhe shoqërorë duhet të punojnë në ngritjen e standardit të kulturës politike participative dhe dialogut kulturor para dhe gjatë zgjedhjeve, me qëllim të krijimit të një atmosfere pozitive në të cilën qytetarët ata duan të marrin pjesë në procesin zgjedhor, me çka do të arrihet një dalje më e lartë dhe nivel i lartë i ndërgjegjësimit të kandidatëve për përcaktimet programore të kandidatëve. Kjo nënkupton:

a) Institucionet të cilat janë të ngarkuara në mënyrë eksplicite për organizimin e zgjedhjeve të zhvillojnë një komponent që do të merret me krijimin e një atmosfere pozitive parazgjedhore. Institucionet kryesisht kujdesen për kuadrin “ligjor” dhe shkeljen e tij, dhe organizatat ndërkombëtare të ngarkuara me monitorimin e zgjedhjeve menaxhohen pothuajse ekskluzivisht sipas të njëjtave kritere. Institucionet duhet të zhvillojnë një program ndër-sektorial që do të punojë ndërmjet dy cikleve zgjedhore për të krijuar një atmosferë pozitive dhe për të inkurajuar pjesëmarrje të lartë.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) duhet të jetë një institucion udhëheqës që duhet të ketë kompetenca të zgjeruara, dhe përmes forcimit të kapaciteteve (njerëzore dhe materiale) të marrë rolin e koordinimit të një qasjeje të tillë ndër-sektoriale.

Agjencia e Shërbimeve Audio dhe Audiovizive dhe Mediatike (ASHAAM) dhe Radio Televizioni Kombëtar (RTK) duhet të jenë institucionet kryesore mediatike në ofrimin e një hapësire publike të drejtë dhe demokratike në të cilën do të dominojnë debatet publike të të gjithë kandidatëve, bazuar në dialogun e ndërsjellë dhe prezantimin e përcaktimeve programore. Në këtë mënyrë do të reduktohej ndjeshëm hapësira për keqinformim dhe manipulim të informacionit. ASHAAM duhet të luajë një rol më serioz në krijimin e një atmosfere pozitive mediatike, e cila si imperativ do të marrë parasysh efektin që shkakton diskursi publik tek qytetarët të cilët duhet të motivohen dhe inkurajohen për të marrë pjesë në procesin zgjedhor. Kundërshtimi i dezinformatave dhe ndikimeve malinje, patjetër të jetë mandati bazë i ASHAAM. Përpyekjet për kundërshtimin e dezinformatave dhe ndikimet malinje nga palët e treta, duke përfshirë kanalet e mediave sociale dhe tradicionale, janë kyçe për mbrojtjen e proceseve demokratike dhe ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit të institucioneve.



b) **Partitë politike** me sjelljen e tyre duhet të demonstrojnë standardin më të lartë të bashkëpunimit pozitiv ndërpartiak, ruajtjen e dialogut politik parimor dhe debat publik inkluziv të vazhdueshëm dhe të hapur që do t'u përkushtohet objektivave programore në vend të sulmeve reciproke. Partitë politike mbajnë përgjegjësinë më të madhe para qytetarëve gjatë zgjedhjeve, sepse pikërisht gjatë zgjedhjeve ata "luftojnë" për besimin që duhet ta justifikojnë në katër vitet e ardhshme. Në këtë mënyrë do të kontribuojnë në forcimin e besimit të qytetarëve ndaj sistemit demokratik dhe ndaj institucioneve në katër vitet e ardhshme. Gjithashtu, në këtë mënyrë partitë politike do të mund të pretendojnë se i kanë realizuar pritshmëritë e qytetarëve të premtuara gjatë fushatës parazgjedhore, e të cilat bazohen në komunikim programor transparent.

c) **Mediat dhe institucionet**, gjegjësisht organizatat e ngarkuara për rregullimin e mediave, siç janë Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), Këshilli i Etikës në Media (KEM) dhe ASHAAM, duhet të punojnë në krijimin e një diskursi pozitiv që do t'i informojë dhe inkurajojë qytetarët të marrin pjesë në zgjedhje. Këtë do ta arrijnë edhe përmes fushatave mediatike dhe duke u ofruar kandidatëve një hapësirë për të hapur çështjet me interes publik, të cilat janë të orientuara drejt objektivave programore dhe me këtë rast ta zvogëlojnë hapësirën në eterin për sulme të ndërsjella dhe retorikës politike manipuluese dhe të pamundësojnë transmetimin jokritik të deklaratave të njëanshme dhe dezinformative.

Analiza e 1647 artikujve gazetaresk tregon se në eterin publik dominon transmetimi i njëanshëm dhe shpeshherë jokritik i deklaratave të politikanëve, të cilat fokusohen kryesisht në retorikën politike apo sulmet ndaj kundërshtarit. Mediat profesionale, veçanërisht ato me shikueshmëri të madhe dhe të prira kryekëput nga interesi publik, duhet të hapin hapësirë për çështje që i interesojnë qytetarët dhe që nuk debatohen fare nga partitë.

d) **Organizatrat qytetare** duhet të punojnë në nxitjen e daljes së qytetarëve, veçanërisht të rinjve dhe votuesve të ardhshëm, si dhe të vetë shfrytëzimit të së drejtës së votës dhe integritetit të të njëjtës.

e) **Organizatrat ndërkombëtare**, misionet diplomatike dhe aktorët demokratikë që veprojnë në Maqedoninë e Veriut duhet t'i orientojnë përpjekjet e tyre drejt mbështetjes së aktorëve vendas që punojnë në ngritjen e standardit në drejtim të kulturës politike participative dhe dialogut para dhe gjatë zgjedhjeve.

f) **Partitë politike patjetër** të braktisin praktikën e keqpërdorimit të retorikës nacionaliste si metodë e mobilizimit negativ të votuesve. Një mënyrë efektive për ta bërë këtë është që partitë politike të braktisin strategjitë e mobilizimit ekskluzivisht të bazave të tyre partiake dhe të thithin legjitimitet dhe integritet përmes një përqindjeje të supozuar të lartë të daljes në zgjedhje. Analiza tregon se partitë politike kur në eterin publik flasin për programin e tyre, ata fokusohen në mesazhe pozitive, ndërsa kur flasin për kundërshtarët politikë, ata janë skajshmërisht negativ.

Analoge me këtë, kur përfaqësuesit e partive janë të ftuar në intervista, fokusohen në arritjet programore të cilat i premtojnë, ndërsa kur marrin pjesë në debate, pozicionohen jashtëzakonisht negativisht ndaj kundërshtarit politik, duke minimizuar mesazhet programore.

Rrjedhimisht, angazhimi i partive për t'u fokusuar kryesisht në arritjet programore si dhe fokusi i medias në arritjet programore në kurriz të fushatës negative, e redukton hapësirën për retorikë nacionaliste dhe komunikim politik të bazuar në sulmin ndaj kundërshtarit, duke nxitur një atmosferë pozitive midis votuesve të papërcaktuar dhe pasqyrimin të ndershëm dhe i korrekt të ofertës së partive.

Nga ana tjetër, partitë në këtë fushatë nuk treguan se janë të prira nga kultura dhe kompromisi politik. Ndonëse disa nga parti politike treguan aftrim të qëndrimeve politike, përshtypja që mund të fitohet nga deklaratat publike është se fushata shfrytëzohet për vendosjen e vijave të ashpra dhe për t'u pozicionuar në negociatat paszgjedhore për koalicione.

Kjo shkakton dëm të dyfishtë. Së pari, sepse deklarimi publik i vijave të forta mobilizon një numër të caktuar qytetarësh, të cilët më vonë zhgënjehen dhe humbasin besimin, gjegjësisht tek ata krijohet një ndjenjë mashtrimi. Së dyti, shkakton ndërtimin e koalicioneve të bazuara në interesa oportuniste dhe nevojë për pushtet, në kurriz të ndërtimit të koalicioneve për shkak të ngjashmërisë ideologjike dhe programore dhe mbrojtjes së interesit publik.

g) Iniciativa të tilla si takime në kuvend ose diskutime në tryeza të rrumbullakëta mund të lehtësojnë marrëdhëniet e tensionuara ndërmjet rivalëve politikë dhe të nxitin dialogun, i cili do të vendosë minimumin e standardeve dhe potencialisht do të identifikojë interesin publik dhe qasjen shtetërore rreth së cilës partitë do të bien dakord dhe do ta zbatojnë këtë qasje në fushatat e ardhshme para zgjedhore.

Nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit ndërpartiak, partitë politike duhet t'i japin prioritet ndërtimit të konsensusit për prioritetet kyçe kombëtare, duke kapërcyer ndarjet partiake në favor të interesave kolektive të cilat shkojnë përtej ndarjeve.

2. Qytetarët duhet të votojnë “PËR” e jo “KUNDËR”, dhe patjetër ta dinë saktësisht se ç’është ajo “PËR”

Gjatë fushatës mediat duhet të punojnë në një përpunim më të detajuar të profileve të kandidatëve që pretendojnë të kenë funksione parlamentare ose ekzekutive. Nëpërmjet përpunimit të qëndrimeve dhe angazhimeve të tyre politike, por edhe nëpërmjet një lloj vetingu publik (sidomos në pjeësn e gjuhës së urrejtjes, dezinformimit, nacionalizmit toksik apo gjuhës që shkakton demotivimin e qytetarëve për të marrë pjesë në zgjedhje), mediat mund ta zvogëlojnë hapësirën në të cilën qytetarët do të votojnë "kundër" dhe do të përcaktohen për qëndrimet programore të partive që konkurrojnë dhe do të shpjegojnë në mënyrë transparente se si do ta përmirësojnë jetën e qytetarëve në katër vitet e ardhshme.



Në të njëjtën kohë, që të nisin ta ndërtojnë besimin e votuesve (veçanërisht atyre të papërcaktuar), partitë politike doemos t'i fokusojnë strategjitë e tyre të komunikimit në llogaridhënien në relacionin premtuar-realizuar, duke reduktuar retorikën politike manipuluese dhe duke forcuar komunikimin. Ata duhet të kenë një komunikim të qartë për masat dhe programet e tyre specifike që i interesojnë qytetarët, si një nga temat që qytetarët, palët, e përmendin pothuajse në mënyrë të parëndësishme në formën e përcaktimeve programore. drejtimi i vettingut, gjyqësori dhe lufta e pamëshirshme kundër korrupsionit) dhe shumë më tepër të fokusuara në akuzimin e kundërshtarëve politikë si të korruptuar.

Një dimension krejtësisht tjetër është transparenca gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për deputetë, vendimet e kongreseve, si dhe përlllogaritja financiare të programeve politike që I paraqesin, e për të cilat duhet të shpjegojnë se si planifikojnë t'i sigurojnë. Me këtë të fundit shmangen premtimet joreale që më vonë i zhgënjejnë qytetarët dhe lëkundin besimin e vetë aktorëve që marrin pjesë në këto zgjedhje.

Përfundimisht, pas mbajtjes së zgjedhjeve, të gjithë aktorët shoqërorë të përpunuar në këtë analizë patjetër të punojnë për të verifikuar premtimet e dhëna në programet parazgjedhore, si të partive ashtu edhe të qeverive të ardhshme. Kjo patjetër të praktikohet nga mediat, organizatat e shoqërisë civile, por edhe nga institucionet që merren drejtpërdrejt ose tërthorazi me procesin zgjedhor.

3. Aktorët politikë patjetër ta ndërtojnë besimin e qytetarëve mes dy cikleve zgjedhore.

Aktorët politikë dhe shoqërorë patjetër t'i përqendrojnë përpjekjet e tyre në ndërtimin e besimit të qytetarëve, siç janë institucionet, si dhe te partitë politike, mediat dhe organizatat civile. Sipas të gjitha hulumtimeve të kryera në Maqedoninë e Veriut në pesë vitet e fundit, besimi në këto kategori të sipërpërmendura është historikisht i ulët, e me këtë po bie edhe besimi në sistemin demokratik.

Forumi për Politika të Arsyeshme e detekton ciklin zgjedhor si një segment kohor që mund të jetë bazë për fillimin e ndërtimit të besimit të qytetarëve. Pikërisht për këtë, fokusi i punës tone do të jetë zbatimi i rekomandimeve të politikave të mësipërme të cilat do të ndikojnë në riorganizimin e periudhës parazgjedhore dhe aktivitetet paszgjedhore në mes dy cikle zgjedhore, në një mënyrë që do të fillojë të ndërtojë besimin e qytetarëve në sistem funksional demokratik.

Aneks 1: Lista e mediave publikimet mediatike të të cialve janë shfrytëzuar për bazën e të dhënave

1. Kanal 5
2. Sitel
3. Alsat
4. TV21
5. Telma
6. MTM.MK
7. SkopjeInfo
8. 360
9. DW:Deutsche Welle
10. Makfaks
11. TV 24
12. 24 info
13. Nova TV
14. Nezavisen
15. Republika
16. Vo centar
17. Sloboden pecat
18. Plusinfo
19. Meta
20. Press 24
21. Civil
22. Alfa
23. Netpress
24. Libertas
25. Nova Makedonija
26. Brif
27. Lokalno
28. E-magazin
29. Fokus
30. Centar mk
31. Vreme mk
32. Vecer press
33. Slobodna Evropa
34. SDK
35. Prizma
36. Denesen
37. Biznis vesti
38. MKD.mk
39. Kurir
40. Faktor
41. Kumanovo news
42. Kumanovski muabeti
43. Gradska mk
44. A1 on
45. Makpress
46. 4News mk
47. MMS mk
48. Pressing
49. Frontline
50. Lider
51. Zoom mk
52. Racin
53. Vestiplus mk
54. Express mk
55. Mnet.mk
56. Puls24 mk
57. Skopje1 mk
58. Opserver
59. Tocka
60. Ohridnews
61. Puls24 mk
62. Infomax
63. Antropol
64. Voanews
65. Tera
66. 365 com mk
67. Mia mk
68. Ima mk
69. Skopsko eho

UDHËZUES PËR POLITIKANË TË VIRTYTSHËM 2.0



Udhëzuesi për politikanë të virtytshëm 2.0 është përpunuar nga ekipi dhe ekspertët e Forumit për politika të arsyeshme: Gordan Georgiev, Ibrahim Mehmeti, Aleksandar Spasenovski dhe Jasmina Trajkoska-Naumoska.

Ky publikim u realizua në kuadër të projektit "Etika dhe politika – lidhja e nyjes" i implementuar nga Forumi për Politika të Arsyeshme. Publikimi u mundësua me mbështetjen e fondacionit jofitimprurës amerikan National Endowment for Democracy. Përbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron pikëpamjet e National Endowment for Democracy.